

20232624547

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J

### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË REVIZIONIT TË INSTRUMENTIT TË NDIHMËS SË PARAAËTARËSIMIT (IPA) (\*)

#### Neni 1

Në Ligjin e Revizionit të Instrumentit të Ndhmës Së Paraanëtarësimit (IPA) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/10, 43/14, 154/15, 27/16, 190/16 dhe 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 251/22), në nenin 2 pika 1) ndryshohet si në vijim:

1. “Instrumenti i Ndhmës Së Paraanëtarësimit” në tekstin e mëtejshëm: IPA) paraqet ndihmë financiare të paraanëtarësimit, e cila sigurohet nga Bashkimi Europian për vendet kandidatë dhe kandidatët e mundshëm për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe përfshin periudhën e programimit (2007-2013), IPA 2 për periudhën e programimit (2014-2020) dhe IPA 3 për periudhën e programimit (2021-2027);

Në pikën 2, pas fjalëve: “(në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshja kornizë për IPA II)”, shtohen fjalët: “, si dhe Marrëveshja Kornizë për Partneritet Financiar ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për procedurat e veçanta për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Instrumentit të Ndhmës së Paraanëtarësimit (IPA III) të ratifikuar me Ligjin e Ratifikimit të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet Financiar ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut të përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për procedurat e veçanta për zbatimin e ndihmës financiare nga Bashkimi për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Instrumentit të Ndhmës së Paraanëtarësimit (IPA III) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 235/22) (në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshja kornizë për IPA III)”.

Në pikën 3, pas fjalëve: “(në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshja sektoriale për IPARD II)” shtohen fjalët: “si dhe Marrëveshja sektoriale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Europian për përcaktimin e dispozitave. për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga Instrumenti i Ndhmës së Paraanëtarësimit në fushën e bashkëpunimit Bujqësi dhe Zhvillim Rural (IPARD III) (në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshja sektoriale për IPARD III)”.

#### Neni 2

Pas nenit 12, shtohet neni i ri 12-a si më poshtë:

#### “Neni 12-a

Për aktivitetet për forcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e programeve të bashkëpunimit tekkufitar, Trupi revizor mund të përdorë fondet nga buxheti i ndihmës teknike të siguruara nga programet e bashkëpunimit tekkufitar në përputhje me nenin 73, paragrafi (2), pika (b) të Marrëveshjes Kornizë për IPA III. ”.

#### Neni 3

Në nenin 19 paragrafi (3) pas pikës 1), shtohet pika e re 2) si më poshtë:

\* Me këtë ligj bëhet harmonizimi me Rregulloren (BE) 2021/2236, datë 15 dhjetor 2021, për rregullat e veçanta të zbatimit të Rregullores (BE) 1529/2021 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit për IPA III (CELEX nr. 32021R2236 ).

"2) revizione tematike;"

Pikat 2), 3) dhe 4) bëhen pika 3), 4) dhe 5).

#### Neni 4

Neni 26 ndryshohet si vijon:

“Në përputhje me dispozitat e Aneksit A, pikës 5 të Marrëveshjes Kornizë për IPA II dhe Aneksit A, klauzolës 9, Anekseve G, D dhe GJ të Marrëveshjes Kornizë për IPA III, si dhe Marrëveshjes Sektoriale për IPARD II dhe Marrëveshjes sektoriale për IPARD III, Trupi revizor i dorëzon raportet dhe mendimet e mëposhtme:

1) raportin vjetor për aktivitetet e revizionit lidhur me fushën përkatëse, i cili parashtrohet jo më vonë se data 15 shkurt për IPA III, përkatësisht jo më vonë se data 15 mars të çdo viti për IPA dhe IPA II deri te Komisioni Europian, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa një kopje parashtrohet te koordinatori nacional i IPA-së dhe te koordinatori nacional i autorizimit;

2) mendimin vjetor të revizionit lidhur me programin e besueshmërisë së raporteve vjetore financiare ose deklaratave/llogarive vjetore, ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve dhe funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, së bashku me raportin vjetor të aktiviteteve të revizionit, i cili parashtrohet jo më vonë se data 15 shkurt për IPA III, përkatësisht jo më vonë se data 15 mars të çdo viti për IPA dhe IPA II deri te Komisioni Europian, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa një kopje parashtrohet te koordinatori nacional i IPA-së dhe koordinatori nacional i autorizimit dhe

3) mendimi i revizionit për raportin përfundimtar të shpenzimeve së bashku me raportin përfundimtar për veprimtarinë e revizionit të dorëzuar nga Koordinatorit Nacional i Autorizimit, i cili dorëzohet brenda tre muajve nga dorëzimi i raportit përfundimtar për shpenzimet në Komisionin Europian, Qeveria e Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe një kopje i dorëzohet Koordinatorit Nacional të IPA-së dhe Koordinatorit Nacional të Autorizimit.”.

#### Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut.